

# RAPORT I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR PARKUN FOTOVOLTAIK 1.5MW<sub>p</sub>



## “DALLASHAJ”

Aplikues:  
“ohm” SH.P.K

Hartuese e raportit:  
Hana Zeka

---

Janar 2026

## **Përmbajtja**

|                                                                                                |    |
|------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Të dhëna për aplikuesin (Investitorin) .....                                                   | 7  |
| Të dhëna kryesore për projektin.....                                                           | 7  |
| Të dhëna për hartuesin e raportit të VNM-së.....                                               | 7  |
| HYRJE .....                                                                                    | 8  |
| BAZA LIGJORE DHE INSTUTICIONALE .....                                                          | 9  |
| PËRSHKRIMI TEKNIK I PROJEKTIT TË PROPOZUAR.....                                                | 10 |
| Kategoria e projektit të propozuar.....                                                        | 10 |
| Përshkrimi i punëve përgatitore për zbatimin e projektit.....                                  | 10 |
| Përshkrimi i karakteristikave kryesore të funksionimit të projektit .....                      | 10 |
| Përshkrimi detal i procesit të prodhimit .....                                                 | 11 |
| Paraqitja e llojit dhe sasisë së burimeve të nevojshme.....                                    | 11 |
| Vlerësimi i gjenerimit të mbeturinave dhe emetimeve gjatë procesit .....                       | 11 |
| Teknologjia e trajtimit, riciklimit dhe asgjësimit të mbeturinave .....                        | 11 |
| Programi për ndërtimin, kohëzgjatjen dhe rehabilitimin .....                                   | 12 |
| Të dhëna për infrastrukturën e nevojshme .....                                                 | 12 |
| Aktivitetet e tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit.....                         | 12 |
| Informacion për lejet dhe licencat e nevojshme.....                                            | 13 |
| Ndërlidhjet e mundshme me projekte të tjera ekzistuese .....                                   | 13 |
| PËRSHKRIMI I LOKACIONIT TË PROPOZUAR.....                                                      | 14 |
| Të dhënat për lokacionin .....                                                                 | 14 |
| Skica dhe planimetria e vendndodhjes .....                                                     | 14 |
| Distanca nga qendrat e banuara.....                                                            | 15 |
| Karakteristikat pedologjike, gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrogeologjike dhe sizmologjike.. | 15 |

|                                                                             |           |
|-----------------------------------------------------------------------------|-----------|
| Furnizimi me ujë .....                                                      | 18        |
| Karakteristikat klimatike .....                                             | 18        |
| Karakteristikat natyrore .....                                              | 18        |
| Karakteristikat e peisazhit .....                                           | 18        |
| Trashëgimia kulturore dhe historike .....                                   | 18        |
| Popullsia dhe karakteristikat demografike .....                             | 19        |
| Objektet ekzistuese.....                                                    | 19        |
| Zona të veçanta dhe të ndjeshme.....                                        | 19        |
| Burimet ujore sipërfaqësore .....                                           | 20        |
| <b>GJENDJA AKTUALE E FAKTORËVE MJEDISOR.....</b>                            | <b>20</b> |
| Raport për gjendjen aktuale të faktorëve mjedisor.....                      | 20        |
| <b>PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË PROJEKTIT.....</b>                         | <b>21</b> |
| Proceset dhe teknologjia e prodhimit .....                                  | 22        |
| Metodat e punës gjatë zbatimit dhe funksionimit.....                        | 22        |
| Plani i lokacionit.....                                                     | 22        |
| Lloji dhe përzgjedhja e materialeve.....                                    | 22        |
| Afati kohor për ekzekutim dhe funksionim .....                              | 22        |
| Madhësia e lokacionit ose objektit .....                                    | 23        |
| Vëllimi i prodhimit .....                                                   | 23        |
| Kontrolli i ndotjes .....                                                   | 23        |
| Trajtimi i mbeturinave .....                                                | 23        |
| Infrastruktura rrugore dhe komunikimi .....                                 | 23        |
| <b>PËRSHKRIMI I NDIKIMIT TË PROJEKTIT NË MJEDIS .....</b>                   | <b>25</b> |
| Përshkrimi i përgjithshëm i ndikimeve të projektit në mjedis .....          | 25        |
| Cilësia e ajrit.....                                                        | 25        |
| Përqendrimi i substancave ndotëse në ajër dhe krahasimi me standardet ..... | 25        |
| Ndikimi në klimë dhe ndryshimet klimatike .....                             | 25        |

|                                                                   |    |
|-------------------------------------------------------------------|----|
| Ndikimi ndërkufitar në ajër .....                                 | 25 |
| Cilësia e ujit.....                                               | 25 |
| Ndikimi në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore .....             | 26 |
| Ndikimi ndërkufitar në ujëra .....                                | 26 |
| Ndryshimet hidromorfologjike dhe ujërat e zeza .....              | 26 |
| Toka.....                                                         | 26 |
| Ndikimi fizik, topografia dhe erozioni .....                      | 26 |
| Ndotja e tokës dhe krahasimi me standardet .....                  | 26 |
| Shfrytëzimi i tokës dhe burimeve natyrore .....                   | 26 |
| Humbja e tokës bujqësore .....                                    | 27 |
| Ndikimi në karakteristikat gjeologjike dhe gjeomorfologjike ..... | 27 |
| Popullsia lokale .....                                            | 27 |
| Ndryshimet demografike .....                                      | 27 |
| Ndikimet vizuale .....                                            | 27 |
| Zhurma, vibrimet dhe shëndeti i njeriut .....                     | 27 |
| Ndikimet socio-ekonomike .....                                    | 27 |
| Ndikimi në strukturën e ekonomisë lokale.....                     | 27 |
| Vendet e punës .....                                              | 28 |
| Kontributi në ekonominë rajonale dhe kombëtare .....              | 28 |
| Ekosistemet dhe gjeologjia.....                                   | 28 |
| Humbja e biodiversitetit .....                                    | 28 |
| Speciet e rralla dhe habitatet.....                               | 28 |
| Qëllimi dhe shfrytëzimi i sipërfaqeve .....                       | 28 |
| Sipërfaqet e ndërtuara dhe të pandërtuara .....                   | 28 |
| Shfrytëzimi i tokës .....                                         | 28 |

|                                                                                                           |    |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Infrastruktura komunale .....                                                                             | 28 |
| Trafiku .....                                                                                             | 28 |
| Furnizimi me ujë .....                                                                                    | 29 |
| Energjia .....                                                                                            | 29 |
| Ujërat e zeza .....                                                                                       | 29 |
| Gjenerimi i mbeturinave.....                                                                              | 29 |
| Pasuritë e mbrojtura natyrore, kulturore dhe veçoritë e peizazhit.....                                    | 29 |
| Informacione shtesë mbi ndikimet .....                                                                    | 29 |
| Zbatimi i projektit dhe punimet e largimit .....                                                          | 29 |
| Ndikimet kumulative.....                                                                                  | 30 |
| Shtrirja hapësinore e ndikimeve negative .....                                                            | 30 |
| Shkarkimi i ujërave të ndotura gjatë ndërtimit.....                                                       | 30 |
| Rrezatimi elektromagnetik gjatë ndërtimit.....                                                            | 30 |
| Emetimet e gazeve serrë gjatë operimit .....                                                              | 30 |
| Ndikimet në ndryshimet klimatike .....                                                                    | 30 |
| <b>PËRSHKRIMI I MASAVE PËR TË PARANDALUAR, REDUKTUAR OSE ELIMINUAR</b><br><b>NDIKIMIN NË MJEDIS</b> ..... | 31 |
| Masat e parashikuara me legjislacion.....                                                                 | 31 |
| Masat në rast aksidentesh dhe fatkeqësish .....                                                           | 31 |
| Zgjidhjet teknike për mbrojtjen e mjedisit .....                                                          | 31 |
| Masa shtesë për reduktimin e ndikimeve .....                                                              | 31 |
| <b>PROGRAMI I MONITORIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS</b> .....                                                 | 32 |
| Programi i monitorimit .....                                                                              | 32 |
| Gjendja mjedisore fillestare .....                                                                        | 32 |
| Parametrat e monitorimit .....                                                                            | 32 |

|                                                                |    |
|----------------------------------------------------------------|----|
| Vendndodhja dhe shpeshtësia e matjeve .....                    | 32 |
| Raportimi i rezultateve .....                                  | 32 |
| Informimi i publikut .....                                     | 32 |
| Monitorimi ndërkufitar .....                                   | 32 |
| PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR.....                               | 33 |
| Mbrojtja mjedisore gjatë gjithë fazave të projektit.....       | 33 |
| Pajtueshmëria me pëlqimin mjedisor .....                       | 33 |
| Sistemi i menaxhimit mjedisor .....                            | 33 |
| INFORMACIONE SHITESË DHE KARAKTERISTIKAT E PROJEKTIT .....     | 33 |
| Informacionet dhe karakteristikat shitesë të projektit .....   | 33 |
| BURIMET E TË DHËNAVE .....                                     | 34 |
| Lista e referimit të burimeve dhe të dhënave të përdorura..... | 34 |
| SHTOJCAT.....                                                  | 35 |
| PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE E PROJEKTIT .....                       | 36 |

## **INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME**

### **Të dhëna për aplikuesin (Investitorin)**

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) është përgatitur me kërkesë të investitorit, me qëllim të marrjes së Pëlqimit Mjedisor për realizimin e projektit të propozuar. Investitor është kompania “ohm” SH.P.K me adresë: Rruga Ahmet Krasniqi, Nr. 40, Prishtinë, Kosovë, me numër të telefonit +383 49 707 089 dhe email [zeka.hana11m@gmail.com](mailto:zeka.hana11m@gmail.com).

### **Të dhëna kryesore për projektin**

Ky raport i VNM-së ka të bëjë me projektin për ndërtimin dhe operimin e një Parku Fotovoltaik me kapacitet të instaluar 1.5 MWp në zonën kadastrale Racaj.

### **Titulli i plotë i projektit:**

Park Fotovoltaik 1.5 MWp “DALLASHAJ”

### **Vendndodhja e projektit:**

Projekti fotovoltaik planifikohet të ndërtohet në parcelën me numër P-70705066-00663-0, e cila ndodhet në zonën kadastrale Rraca, Komuna Gjakovë. Sipërfaqja e përgjithshme e kësaj parcele është 3.5 hektarë.

### **Të dhëna për hartuesin e raportit të VNM-së**

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është hartuar nga një eksperte e licencuar, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.

Hartuese e raportit është Hana Zeka - Eksperte e licencuar nga MMPH për hartimin e raporteve të VNM-së) me adresë në Prishtinë, me numër telefoni +383 45 640 200 dhe email [hana.zeka@ozon-space.com](mailto:hana.zeka@ozon-space.com).

## HYRJE

Ky dokument paraqet një Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, për projektin Parku Solar Fotovoltaik 1.5 MWp ku aplikues është kompania “ohm” sh.p.k.

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Parkun Solar fotovoltaik 1.5 MWp, paraqet një dokument të rëndësishëm dhe të domosdoshëm për marrjen e pëlqimit mjedisor. Me anë të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të projektit do të identifikohen të gjitha rreziqet mjedisore dhe ndikime negative dhe pozitive, masat që do të parashtrohen me qëllim të parandalimit të ndikimeve negative mjedisore nga ndërtimi dhe operimi i Parkut Fotovoltaik.

Si bazë për hartimin e raportit të VNM-së është gjendja ekzistuese fizike e terrenit, studimet mjedisore ekzistuese për zonën e projektit, legjislacioni në fuqi i Republikës së Kosovës, direktivat e BE-së dhe praktikrat e mira mjedisore. Qëllimi i VNM-së është që zona ku do të realizohet projekti gjatë fazave të zhvillimit, që përfshijnë ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen, dhe pas përfundimit të jetës, të analizohen për nga aspektet mjedisore ku do të bëhen të qarta të gjitha ndikimet e mundshme negative mjedisore dhe masat që do të ndërmerren për zbutjen apo largimin e tërësishëm të këtyre ndikimeve.

Në thelb, projekti paraqet një përfitim mjedisor për Kosovën duke reduktuar varësinë nga lëndët djegëse fosile, uljen e emetimeve të gazrave serrë, uljen e ndotjes mjedisore, dhe përmirësimin e gjendjes mjedisore në rajon.

Projekti Parku Solar Fotovoltaik 1.5 MWp ka për qëllim që të shfrytëzoj energjinë e ripërtëritshme në përputhje e legjislacionin dhe kërkesat vendore. Në përputhshmëri me këto kërkesa, projekti do të ndjek hapat të cilët aprovojnë realizimin e projektit.

Raporti është përgatitur sipas kërkesave të kornizës ligjore mjedisore të Kosovës, veçanërisht sipas Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis - Ligji Nr.08/L-181. Raporti është punuar në bashkëpunim të ngushtë me investitorin, për hartimin e tij janë përdorur të dhëna nga përshkrimi teknik i projektit si dhe të dhëna dhe materiale për projekte të ngjashme, janë realizuar vizita në lokacionin e projektit për hartimin e këtij raporti.

## **BAZA LIGJORE DHE INSTUTICIONALE**

Bazë për hartimin e raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis i aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 2023 me Nr.08/L-181. Ky ligj përcakton të gjitha procedurat për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim të VNM-së. Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis ka për qëllim që të siguroj një vlerësim të qartë të ndikimeve mjedisore të projekteve apo veprimtarive që do të realizohen me qëllim që të parandalojnë dhe të zvogëlojnë apo mënjanojnë efektet negative në mjedis në kohën e duhur.

Për përgatitjen e këtij raporti janë shfrytëzuar legjislacioni ekzistues i Republikës së Kosovës si dhe rregullat relevante dhe praktikrat e mira nga vendet e ndryshme të BE-së, direktivat përkatëse për mjedis siç është Direktiva e VNM-së, dhe Direktiva e Habitave 92/43/EEC, 1992. Ligjet më të rëndësishme të aplikuara për hartimin e VNM-së për projektin për prodhimin e energjisë elektrike me diell janë si më poshtë:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.08/L-181
- Udhëzim Administrativ Nr.04/2025 për përmbajtjen, metodologjinë dhe përputhshmërinë e raportit me kërkesat ligjore, praktikrat e zbatueshme dhe aspektet e tjera teknike të raportit
- Ligji për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174
- Ligji për Ndërtim Nr. 04/L-110
- Ligji Nr. 08/L-112 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Tokën Bujqësore Nr. 02/L- 26
- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233
- Ligji për Ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji Nr. 03/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugë Nr. 2003/11
- Ligji për Kimikate Nr. 04/L-197
- Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 08/L-025
- Ligji Nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Mbeturina Nr. 04/L-060
- Ligji për Mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102

- Ligji për Mbrojtjen nga Zjarri Nr. 04/L-012
- Udhëzimi Administrativ Nr. 30/2014 për kushtet, mënyrat , parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujqor.

## **PËRSHKRIMI TEKNIK I PROJEKTIT TË PROPOZUAR**

### **Kategoria e projektit të propozuar**

Projekti i propozuar i përket kategorisë së instalimeve për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme, konkretisht një central fotovoltaike tokësor me kapacitet të instaluar 1.5 MWp. Projekti parashihet të lidhet në rrjetin distributiv të energjisë elektrike në Kosovë, sipas kushteve teknike të operatorit të shpërndarjes (KEDS), duke mundësuar injektimin e energjisë së prodhuar në rrjet dhe shfrytëzimin e saj përmes marrëveshjes së neto-matjes.

### **Përshkrimi i punëve përgatitore për zbatimin e projektit**

Punët përgatitore për zbatimin e projektit lidhen me përgatitjen e parcelës ku do të ndërtohet projekti fotovoltaike, e cila është parcela me numër P-70705066-00663-0 në zonën kadastrale Rracaj, Komuna Gjakovë, me sipërfaqe të përgjithshme 3.5 hektarë.

Në kuadër të kësaj faze parashihet sistemimi i terrenit dhe organizimi i hapësirave funksionale për vendosjen e strukturave mbështetëse të paneleve, krijimi i qasjeve dhe rrugëve të brendshme, përgatitja e kanaleve për shtrirjen e kablllove, si dhe punët për vendosjen e elementeve bazë të infrastrukturës elektrike dhe të tokëzimit, me qëllim që instalimi të kryhet në mënyrë të sigurt dhe të qëndrueshme.

### **Përshkrimi i karakteristikave kryesore të funksionimit të projektit**

Funksionimi i impiantit bazohet në shndërrimin e energjisë diellore në energji elektrike përmes moduleve fotovoltaike, të cilat prodhojnë rrymë të drejtë (DC). Kjo energji më pas shndërrohet në rrymë alternative (AC) përmes invertorëve të lidhur në rrjet dhe, përmes nënstacionit ngritës, përshtatet në nivelin e nevojshëm të tensionit për t'u injektuar në rrjetin distributiv

Sistemi është i konceptuar që të operojë në mënyrë të automatizuar dhe të monitorohet vazhdimisht përmes pajisjeve të monitorimit dhe regjistrimit të të dhënave, me qëllim të optimizimit të

performancës dhe identifikimit të hershëm të anomaleve.

### **Përshkrimi detal i procesit të prodhimit**

Procesi teknologjik i prodhimit fillon me kapjen e rrezatimit diellor nga panelet fotovoltaike të instaluar në terren dhe gjenerimin e energjisë elektrike në formë DC. Energjia DC transmetohet përmes kabllave drejt invertorëve, të cilët e konvertojnë atë në energji AC trefazore të përshtatshme për rrjet. Më pas, energjia grumbullohet në kuadrot shpërndarëse AC dhe dërgohet drejt nënstacionit ngritës 10(20)/0.4 kV, ku realizohet transformimi i nevojshëm dhe lidhja përfundimtare me rrjetin distributiv sipas kushteve të përcaktuara.

### **Paraqitja e llojit dhe sasisë së burimeve të nevojshme**

Burimi kryesor i nevojshëm për operimin e projektit është rrezatimi diellor, ndërsa burimet mbështetëse lidhen me përdorimin e tokës dhe pajisjeve elektro-teknike. Sipas dokumentacionit teknik, projekti parashikon instalimin e rreth 2,755 paneleve diellore, secili me kapacitet 545 W, të montuara në struktura metalike mbështetëse, si dhe përdorimin e 16 invertorëve me kapacitet 100/120 kW për konvertimin DC/AC.

Sipërfaqja totale e parcelës është 3.5 ha dhe ajo do të shfrytëzohet si për vendosjen e moduleve ashtu edhe për infrastrukturën ndihmëse, si rrugë dhe objekte mbështetëse.

### **Vlerësimi i gjenerimit të mbeturinave dhe emetimeve gjatë procesit**

Gjatë fazës së ndërtimit pritet të gjenerohen mbeturina të zakonshme të punimeve, kryesisht mbetje inerte nga gërmimet dhe nivelimet, mbetje nga paketimet e materialeve dhe sasi të kufizuara mbetjesh të tjera jo të rrezikshme. Gjatë fazës së operimit, projekti nuk karakterizohet nga procese djegieje apo procese industriale që prodhojnë emetime në ajër, ndërsa mbeturinat janë minimale dhe lidhen kryesisht me mirëmbajtjen periodike të pajisjeve dhe elementeve të sistemit. Në aspektin e sigurisë elektrike, projekti parashihet masa të tokëzimit dhe mbrojtjes ndaj mbetësioneve dhe rrufesë, të cilat kontribuojnë në funksionim të qëndrueshëm dhe reduktim të rreziqeve operative.

### **Teknologjia e trajtimit, riciklimit dhe asgjësimit të mbeturinave**

Menaxhimi i mbeturinave gjatë ndërtimit do të realizohet përmes ndarjes dhe dorëzimit të tyre tek operatorë të licencuar ose në lokacione të autorizuar, në përputhje me kërkesat ligjore. Në fazën e

operimit, mbeturinat e krijuara nga mirëmbajtja do të menaxhohen sipas natyrës së tyre, ndërsa pajisjet kryesore të sistemit (panelet fotovoltaike, invertorët dhe komponentët elektrikë) në fund të jetës së shfrytëzimit parashihet të trajtohen përmes subjekteve të autorizuara për riciklim dhe trajtim të pajisjeve elektrike/elektronike, me synim rikuperimin e materialeve dhe minimizimin e ndikimeve mjedisore.

### **Programi për ndërtimin, kohëzgjatjen dhe rehabilitimin**

Projekti përfshin fazën e ndërtimit dhe instalimit, e cila është e kufizuar në kohë dhe realizohet pas përfundimit të punëve përgatitore dhe instalimeve elektrike. Faza e operimit konsiderohet afatgjatë, në përputhje me jetëgjatësinë tipike të sistemeve fotovoltaike, e cila zakonisht shtrihet deri në 25 vjet dhe më shumë, bazuar në parimet e garancisë së performancës së moduleve.

Pas përfundimit të funksionimit, projekti parashikon çmontimin e pajisjeve, largimin e elementeve të instalimit dhe rehabilitimin e sipërfaqes, në mënyrë që toka të kthehet në një gjendje të përafërt me atë paraprake.

### **Të dhëna për infrastrukturën e nevojshme**

Infrastruktura e nevojshme për projektin përfshin instalimin e strukturave mbështetëse metalike me pjerrësi 20°, shtrirjen e kablllove të fuqisë dhe kontrollit, kuadro shpërndarëse DC dhe AC, mbrojtjen nga mbitensionet me SPD në anën DC dhe AC, si dhe sistemin e tokëzimit me rezistencë totale jo më të lartë se 1 Ohm.

Element thelbësor i infrastrukturës është nënstacioni ngritës 10 (20)/ 0.4 kV, i konceptuar si kabinë betoni e parapërgatitur, i pajisur me transformatorë dhe blloqe të tensionit të mesëm dhe të ulët, për të mundësuar ndërlidhjen e sigurt dhe të qëndrueshme me rrjetin.

### **Aktivitetet e tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit**

Sipas konceptit të projektit, nuk parashihet ndërtim i rezidencave të përhershme apo kampeve të banimit. Megjithatë, gjatë fazës së ndërtimit mund të ketë nevojë për vendosje të përkohshme të hapësirave për organizim pune, depozitimin e pajisjeve, mjeteve dhe materialeve, si dhe për shërbime mbështetëse për ekipet e punës, brenda standardeve të sigurisë dhe kërkesave organizative të kantierit.

## Informacion për lejet dhe licencat e nevojshme

Për zbatimin e projektit kërkohet sigurimi i Pëlqimit Mjedisor, si dhe pëlqimeve dhe autorizimeve të ndërlidhjes elektroenergjetike, përfshirë pëlqimin elektroenergjetik dhe kushtet teknike të përcaktuara nga KEDS. Gjithashtu, projekti do të kërkojë leje ndërtimore dhe dokumentacion përcjellës sipas legjislacionit në fuqi, si dhe dokumentacion teknik dhe verifikime për komisionimin dhe pranimin e instalimeve.

## Ndërlidhjet e mundshme me projekte të tjera ekzistuese

Ndërlidhja kryesore e projektit është me rrjetin distributiv ekzistues të energjisë elektrike, përmes nënstacionit ngritës dhe pajisjeve të ndërlidhjes sipas kërkesave të operatorit të rrjetit.

Projekti nuk është i varur nga procese të tjera industriale në zonë, por integrimi i tij realizohet në kuadër të infrastrukturës energjetike ekzistuese, duke mundësuar furnizimin e rrjetit me energji nga burime të ripërtëritshme.



Figure 1 Projekti ideor - Parku Fotovoltaik 1.5 MWp - Dallashaj

# PËRSHKRIMI I LOKACIONIT TË PROPOZUAR

## Të dhënat për lokacionin

Projekti për ndërtimin e Parkut Fotovoltaik me kapacitet të instaluar 1.5 MWp është planifikuar të realizohet në parcelën kadastrale me numër P-70705066-00663-0, e cila ndodhet në zonën kadastrale Rracaj, në territorin e Komunës së Gjakovës. Kjo parcelë ka një sipërfaqe të përgjithshme prej rreth 3.5 hektarë dhe aktualisht përfaqëson një zonë pyjore, ku sipas HZK, në kuadër të funksioneve dhe aktiviteteve të lejuara përkohësisht hyn edhe energjia e ripërtrishme.

## Skica dhe planimetria e vendndodhjes


Vendndodhja e projektit është e paraqitur në dokumentacionin teknik përkatës përmes situacionit dhe planimetrisë së detajuar, ku janë të evidentuara kufijtë e parcelës, orientimi gjeografik, vendosja e paneleve fotovoltaike, infrastruktura e brendshme, rrugët e qasjes dhe pozicionimi i nënstacionit ngritës. Orientimi i terrenit dhe konfigurimi hapësinor janë të favorshme për shfrytëzimin optimal të rrezatimit diellor.



*Figure 2 Skica e vendndodhjes së projektit fotovoltaik 1.5 MWp - Dallashaj*

### Distanca nga qendrat e banuara

Lokacioni i propozuar ndodhet në distancë të konsiderueshme nga zonat e dendura të banuara, duke reduktuar në minimum ndikimet e mundshme ndaj popullsisë përreth. Vendbanimet më të afërta janë të shpërndara dhe të karakterit rural, ndërsa zona e projektit nuk përfshin objekte banimi brenda parcelës. Distancat dhe marrëdhënia hapësinore me qendrat e banuara janë të dokumentuara edhe përmes materialit fotografik dhe hartografik. Distanca më e afërt me një vendbanim nga projekti është rreth 530m vijë ajrore.



*Figure 3 Distanca mes projektit dhe vendbanimit më të afërt*

### Karakteristikat pedologjike, gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrogeologjike dhe sizmologjike

Terreni ku parashihet realizimi i projektit karakterizohet nga forma të relievit relativisht të rrafshëta deri lehtë të valëzuara, tipike për zonën e Dukagjinit. Nga aspekti pedologjik, toka është e përshtatshme për ndërtime të lehta dhe instalime teknike, ndërsa nuk identifikohen procese aktive erozive që do të cenonin stabilitetin e strukturave. Gjeologjikisht, zona përbëhet nga formacione të qëndrueshme sedimentare, të cilat ofrojnë kushte të mira për vendosjen e strukturave mbështetëse. Nga aspekti hidrogeologjik, nuk janë identifikuar burime ujore nëntokësore të ndjeshme në vetë parcelën, ndërsa nga aspekti sizmologjik, zona i përket një rajoni me aktivitet sizmik të moderuar, në përputhje me karakteristikat sizmike të territorit të Kosovës, për të cilat projekti është dimensionuar

sipas standardeve teknike në fuqi. Më poshtë janë të dhëna të përgjithshme për komunën e Gjakovës në lidhje me të dhënat pedologjike, gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrogeologjike dhe sizmologjike.

## **Pedologjia**

Territori i komunës karakterizohet me përbërje të ndryshme pedologjike dhe morfologjike. Në pjesën rrafshinore, në lartësinë më të ulët mbidetare përreth luginës së lumit dhe fushëgropës së Gjakovës, përgjatë tërë gjatësisë së saj, dominojnë tokat shumë të pjellshme. Këto janë toka mjaft produktive, që japin edhe rendimente të mira nga të mbjellat me kultura të ndryshme bimore.

Sipërfaqet e rrafshëta, janë toka të pjellshme dhe të mbjella me kultura të ndryshme bimore, shpesh edhe me bimë industriale, si duhan etj. Luginat aluviale lumore kanë tokë të përshtatshme për kultivimin e shumë llojeve të kulturave bimore.

| <b>Kategoritë gjeologjike</b>                                         | <b>Sipërfaqja (ha)</b> | <b>%</b> |
|-----------------------------------------------------------------------|------------------------|----------|
| Alluvium                                                              | 4,997.00               | 9.03     |
| Deluvium                                                              | 464.47                 | 0.84     |
| Gabbro                                                                | 326.68                 | 0.59     |
| Massive sandy limestone with rudists                                  | 1,290.32               | 2.33     |
| Serpentinised periodotite                                             | 1,960.00               | 3.54     |
| Pyroxenite                                                            | 255.44                 | 0.46     |
| Serpentine                                                            | 1,633.00               | 2.95     |
| Sandstone, phyllite, chlorite, schist, conglomerate, chert, limestone | 1,960.00               | 3.54     |
| Limestone, dolomite                                                   | 188.60                 | 0.34     |
| Keratophyre, quartz keratophyre                                       | 22.28                  | 0.04     |
| Limestone, marlstone, calcarenite with chert                          | 5.38                   | 0.01     |
| Limestone, dolomite, breccia                                          | 347.50                 | 0.63     |
| Feldspar-peridotite rock                                              | 116.50                 | 0.21     |
| Glacial sediment (moraine)                                            | 455.80                 | 0.82     |
| Gabbro-diabase                                                        | 1,367.00               | 2.47     |
| River terrace                                                         | 10,479.00              | 18.93    |

|                                                                                      |           |       |
|--------------------------------------------------------------------------------------|-----------|-------|
| Lake and river sediments                                                             | 4,648.00  | 8.40  |
| Sand, clay, gravel, partly tuffite and lignite                                       | 16,250.00 | 29.35 |
| Proluvium                                                                            | 102.40    | 0.18  |
| Orthoschist (epidote, actinolite and chlorite schist)                                | 49.45     | 0.09  |
| Marl, clay, sand, gravel                                                             | 4,248.00  | 7.67  |
| Diabase, spilite, basalt                                                             | 724.70    | 1.31  |
| Conglomerate, breccia, sandstone, limestone                                          | 1,922.00  | 3.47  |
| Clastic sediments with fragments of diabase, chert, limestone with algae and rudists | 184.40    | 0.33  |

### Gjeologjia, tokat dhe sizmologjia

Në pikëpamjen hapësinore, është vlerësuar përshtatshmëria e terrenit për ndërtim duke u bazuar në kritere të bartshmërisë dhe stabilitetit në terrenet stabile, kushtësisht-stabile dhe jo-stabile. Terreni në këtë rajon është i prirur ndaj aktivitetit sizmik dhe mund të përjetojë tërmete me intensitet deri në 6-7 shkallë të rihterit. Të dhënat gjeologjike tregojnë se toka e Gjakovës përmban lloje të ndryshme të shkëmbinjve, të radhitura si më poshtë.




Figure 4 Formacioni Gjeologjik

## **Furnizimi me ujë**

Projekti nuk kërkon furnizim të përhershëm me ujë për qëllime teknologjike gjatë fazës së operimit. Uji mund të nevojitet vetëm në mënyrë të kufizuar gjatë fazës së ndërtimit dhe për mirëmbajtje sporadike, si pastrimi i paneleve fotovoltaike, dhe kjo do të realizohet përmes furnizimit të kontrolluar, pa ndikuar në burimet lokale të ujit.

## **Karakteristikat klimatike**

Klima këtu karakterizohet si kontinentale me ndikime mesdhetare, me verë të nxehtë dhe dimër të ftohtë. Muaji më i nxehtë është Gushti me një temperaturë mesatare prej +22.2°C, ndërsa muaji më i ftohtë është Janari me një temperaturë mesatare prej -0.1°C.

Gjakova ndodhet në një pozitë gjeografike që e kushtëzon klimën kontinentale me ndikime mesdhetare, duke e bërë atë të ndryshme nga klima e zonave tjera të Kosovës. Temperatura mesatare vjetore është +11.9°C, ndërsa temperatura mesatare gjatë vegjetacionit është +18,6°C. Sasia e reshjeve vjetore është 754,8mm, ndërsa sasia e reshjeve gjatë vegjetacionit është 342,90mm.

## **Karakteristikat natyrore**

Zona ku planifikohet projekti nuk përfshin habitate të mbrojtura, zona me biodiversitet të veçantë apo ekosisteme të ndjeshme. Terreni përreth përdoret kryesisht për aktivitete bujqësore ose mbetet i paurbanizuar, ndërsa flora dhe fauna janë tipike për zonat kodrinore të rajonit të Dukagjinit.

## **Karakteristikat e peisazhit**


Nga aspekti i peisazhit, projekti do të integrohet në një ambient kryesisht pyjor. Instalimi i paneleve fotovoltaike me lartësi të ulët dhe me orientim të njëtrajtshëm nuk pritet të shkaktojë ndryshime të theksuara vizuale, ndërsa ndikimi në peisazh vlerësohet si i moderuar dhe i kthyeshëm pas përfundimit të ciklit të jetës së projektit.

## **Trashëgimia kulturore dhe historike**

Në zonën e projektit dhe në afërsi të saj nuk janë identifikuar objekte të mbrojtura të trashëgimisë kulturore apo historike. Gjithsesi, në rast të zbulimit të papritur të ndonjë elementi arkeologjik gjatë punimeve, do të zbatohen procedurat ligjore për njoftimin e institucioneve kompetente.

## Popullsia dhe karakteristikat demografike

Popullsia dhe karakteristikat e saj luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimet e gjithmbarshme të territorit. Bazuar në dinamikën e popullsisë sipas vendbanimeve dhe strukturave demografike, është e mundur edhe planifikimi hapësinor i territorit. Një nga karakteristikat kritike të hapësirës së analizuar, për sa i përket përcaktimit të ndikimeve të mundshme në mjedis, është popullsia dhe demografia e saj. Këto shënime kanë kuptimin e tyre të plotë në hulumtimin specifik të ndikimeve negative të mundshme në popullatën që jeton në hapësirën e analizuar. Pranë zonës në të cilën është planifikuar të ndërtohet Impianti Fotovoltaik 1.5 MWp, nuk ndodhen objektet të banimit.



*Figura 5 Komuna e Gjakovës në hartën e Kosovës*

## Objektet ekzistuese

Brenda parcelës së projektit nuk ka objekte të ndërtuara të përhershme që do të kërkonin prishje apo zhvendosje. Në afërsi mund të ekzistojnë pyje, toka bujqësore dhe infrastrukturë bazike, të cilat nuk cenohen nga realizimi i projektit.

## Zona të veçanta dhe të ndjeshme

Bazuar në karakteristikat e zonës, lokacioni i projektit nuk përfshin zona të shpallura për kërkime shkencore, vende arkeologjike, zona të mbrojtura natyrore apo zona të veçanta me ndjeshmëri të lartë mjedisore. Projekti zhvillohet në një zonë që lejon zhvillime energjetike të këtij lloji.

### **Burimet ujore sipërfaqësore**

Në sipërfaqen ku realizohet projekti nuk janë të pranishme burime ujore sipërfaqësore, si lumenj apo liqene. Po ashtu, në afërsi të drejtpërdrejtë nuk identifikohen trupa ujorë që do të mund të ndikoheshin nga aktivitetet e projektit, çka redukton ndjeshëm rrezikun e ndikimeve hidrologjike.

## **GJENDJA AKTUALE E FAKTORËVE MJEDISOR**

### **Raport për gjendjen aktuale të faktorëve mjedisor**

Territori i Komunës së Gjakovës karakterizohet nga një biodiversitet relativisht i pasur dhe i larmishëm, si rezultat i ndërthurjes së kushteve natyrore, gjeografike, pedologjike dhe klimatike. Prania e ekosistemeve të ndryshme, duke përfshirë zonat pyjore, livadhet, tokat bujqësore, si dhe afërsia me sisteme ujore dhe zona malore, krijon kushte të favorshme për zhvillimin e florës dhe faunës tipike për këtë rajon. Në territorin e komunës përfshihet edhe Parku Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, i cili përfaqëson një zonë me vlera të theksuara natyrore dhe biodiversitet të lartë, megjithëse zona e projektit nuk ndodhet brenda kufijve të kësaj hapësire të mbrojtur.

Zona ku parashihet realizimi i projektit karakterizohet nga pyje të degraduara ose të prera në të kaluarën, çka evidentohet edhe nga analizimi i imazheve satelitore. Gjatë verifikimit në terren është konstatuar se në këtë zonë është zhvilluar një pyll i ri, i përzier, me dominim të dushkut. Përbërja floristikë përfshin kryesisht lloje të gjinisë *Quercus*, si *Quercus pubescens*, *Quercus cerris* dhe *Quercus petraea*, të shoqëruara nga lloje të tjera drunore dhe shkurre si *Ulmus glabra*, *Carpinus betulus*, *Carpinus orientalis*, *Corylus avellana*, *Corylus colurna*, *Cornus mas*, *Cornus sanguinea*, *Betula alba*, si dhe ndonjë individ i *Pinus sylvestris*. Prania e disa llojeve indikatore, si *Juniperus communis*, *Pteridium aquilinum*, *Rubus fruticosus* dhe *Colutea arborescens*, tregon se zona ndodhet në një fazë suksesionale të rikuperimit natyror të vegjetacionit.

Shtresa barishtore përfaqësohet nga lloje të zakonshme për këtë rajon, si *Helleborus odorus*, *Fragaria vesca*, *Bellis perennis*, *Taraxacum officinale*, *Lamium purpureum*, *Galium cruciata*, *Galium verum*,

*Orchis morio dhe Viola sp.* Këto lloje janë tipike për habitatet gjysmë-natyrë dhe nuk konsiderohen specie me rëndësi të veçantë konservuese në nivel lokal apo kombëtar.

Fauna e zonës përreth përbëhet kryesisht nga lloje të zakonshme të shpezëve (Aves), përfshirë shpezë këngëtare dhe grabitës, me përfaqësues nga familjet Falconidae dhe Accipitridae. Në zonë hasen shpezë të përhershme, si harabelat, pëllumbi i egër, kumria, kukuvajka, huti dhe anëtarë të familjes Corvidae, si dhe shpezë migratore që shfaqen sezonalisht gjatë verës, vjeshtës ose pranverës. Këto specie janë tipike për zonat rurale dhe pyjore të rajonit dhe nuk janë të klasifikuara si specie të rrezikuara në nivel lokal.

Në përgjithësi, zona e projektit dhe rrethina e saj përfaqësojnë një ambient me biodiversitet të moderuar, të përbërë kryesisht nga specie të zakonshme, pa praninë e habitateve strikte të mbrojtura apo të specieve me status të veçantë mbrojtjeje.

## **PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË PROJEKTIT**

### **Përshkrimi i alternativave të realizueshme**

Në kuadër të procesit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis janë shqyrtuar alternativat e realizueshme për zhvillimin e projektit të parkut fotovoltai, duke marrë parasysh aspektet teknike, mjedisore, hapësinore dhe ligjore. Alternativat e shqyrtuara përfshijnë zgjedhjen e lokacionit, teknologjinë e prodhimit të energjisë, mënyrën e organizimit të punimeve, si dhe alternativën e mos-zbatimit të projektit.

### **Arsyetime për zgjedhjen e alternativës së preferuar**

Përzgjedhja e alternativës së propozuar është bërë duke u bazuar në kritere të qarta teknike dhe mjedisore, me qëllim minimizimin e ndikimeve negative dhe rritjen e përfitimeve afatgjata. Alternativa e zgjedhur ofron kushte të favorshme për prodhimin e energjisë nga burime të ripërtëritshme, shfrytëzon një zonë me vlera të moderuara ekologjike dhe është në përputhje me dokumentet planifikuese dhe legjislationin në fuqi.

### **Alternativa e vendndodhjes ose rrugës**

Janë shqyrtuar mundësi të ndryshme të vendndodhjes brenda territorit të komunës, por lokacioni i zgjedhur konsiderohet më i përshtatshmi për shkak të ekspozimit të mirë ndaj rrezatimit diellor,

mungesës së zonave të mbrojtura, distancës nga qendrat e banuara dhe afërsisë me infrastrukturën ekzistuese energjetike. Ekzistojnë rrugë që përdoren nga banoret e asaj zone të cilët mundësojnë transportin e materialeve dhe pajisjeve pa nevojë për ndërhyrje të mëdha infrastrukturore.

### **Ndikimet në mjedis dhe shëndetin e njeriut**

Alternativa e zgjedhur vlerësohet se ka ndikime minimale në mjedis dhe shëndetin e njeriut, krahasuar me alternativat e tjera të mundshme. Projekti nuk përfshin procese djegieje apo emetime ndotëse gjatë fazës së operimit dhe kontribuon në reduktimin e emetimeve të gazeve serrë përmes prodhimit të energjisë së pastër.

### **Proceset dhe teknologjia e prodhimit**

Teknologjia e zgjedhur bazohet në përdorimin e moduleve fotovoltaike për shndërrimin e rrezatimit diellor në energji elektrike, e cila më pas konvertohet në rrymë alternative përmes inverterëve dhe dërgohet në rrjetin distributiv. Kjo teknologji është e provuar, e qëndrueshme dhe gjerësisht e aplikuar, me ndikime të ulëta mjedisore krahasuar me teknologjitë konvencionale të prodhimit të energjisë.

### **Metodat e punës gjatë zbatimit dhe funksionimit**

Gjatë fazës së ndërtimit dhe funksionimit do të aplikohen metoda pune që respektojnë standardet e sigurisë, mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit në punë. Punimet do të organizohen në mënyrë të tillë që të kufizohen ndërhyrjet në terren dhe të shmangen dëmtimet e panevojshme të mjedisit përreth.

### **Plani i lokacionit**

Plani i lokacionit parashikon vendosjen racionale të paneleve fotovoltaike, infrastrukturës elektrike dhe rrugëve të brendshme, duke respektuar kufijtë e parcelës dhe kushtet topografike të terrenit. Ky plan mundëson funksionim efikas dhe mirëmbajtje të lehtë të impiantit.

### **Lloji dhe përzgjedhja e materialeve**

Materialet e përdorura për realizimin e projektit do të jenë certifikuar dhe të përzgjedhura sipas standardeve ndërkombëtare, me qëllim garantimin e sigurisë, qëndrueshmërisë dhe jetëgjatësisë së impiantit. Përzgjedhja e materialeve merr parasysh edhe mundësinë e riciklimit në fund të ciklit jetësor të projektit.

### **Afati kohor për ekzekutim dhe funksionim**

Afati kohor për ndërtimin e projektit është i kufizuar dhe parashihet të realizohet brenda periudhës së lejuar nga legjislacioni përkatës. Funksionimi i impiantit planifikohet të jetë afatgjatë, në përputhje me jetëgjatësinë teknike të pajisjeve fotovoltaike minimum 10 vjet.

### **Madhësia e lokacionit ose objektit**

Sipërfaqja e përgjithshme e parcelës është 3.5 hektarë ndërsa madhësia e lokacionit ku do të vendosen panelet solare është përshtatur me kapacitetin e projektuar të impiantit, duke siguruar hapësirë të mjaftueshme për vendosjen e paneleve, infrastrukturës ndihmëse dhe rrugëve të qasjes, pa tejkaluar kufijtë e parcelës së përcaktuar.

### **Vëllimi i prodhimit**

Vëllimi i prodhimit të energjisë elektrike përcaktohet nga kapaciteti i instaluar i parkut fotovoltaike dhe kushtet klimatike të zonës, duke kontribuar në rritjen e prodhimit të energjisë nga burime të ripërtëritshme në nivel lokal dhe kombëtar.

### **Kontrolli i ndotjes**

Alternativa e zgjedhur siguron kontroll efektiv të ndotjes, pasi gjatë operimit nuk gjenerohen ndotje të ajrit, ujit apo tokës. Gjatë fazës së ndërtimit do të zbatohen masa standarde për kontrollin e pluhurit, zhurmës dhe menaxhimin e mbeturinave.

### **Trajtimi i mbeturinave**

Mbeturinat e gjeneruara gjatë ndërtimit dhe mirëmbajtjes do të menaxhohen në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke përfshirë riciklimin, ripërdorimin dhe asgjësimin e kontrolluar përmes operatorëve të licencuar.

### **Infrastruktura rrugore dhe komunikimi**

Projekti shfrytëzon infrastrukturën ekzistuese rrugore për qasje në lokacion, ndërsa brenda parcelës parashihen vetëm rrugë funksionale për mirëmbajtje dhe operim, pa krijuar nevojë për ndërtime të reja të mëdha infrastrukturore.

### **Përgjegjësia dhe procedurat për menaxhimin e mjedisit**

Menaxhimi i mjedisit gjatë zbatimit dhe funksionimit të projektit do të realizohet përmes procedurave të brendshme dhe përgjegjësi të qarta të investitorit dhe operatorit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe kushtet e pëlqimit mjedisor.

### **Trajnimet**

Personeli i angazhuar në projekt do të trajnohet për çështjet e sigurisë, mbrojtjes së mjedisit dhe operimit të pajisjeve, duke siguruar zbatim korrekt të procedurave dhe minimizim të rreziqeve.

### **Monitorimi**

Do të zbatohet monitorim i vazhdueshëm i funksionimit të impiantit dhe aspekteve mjedisore relevante, me qëllim identifikimin e hershëm të çdo devijimi nga kushtet e lejuara.

### **Planet për situata emergjente**

Projekti parashikon plane për menaxhimin e situatave emergjente, duke përfshirë reagimin ndaj zjarreve, defekteve teknike apo ngjarjeve të tjera të paparashikuara, në përputhje me rregulloret e sigurisë.

### **Demolimi dhe rehabilitimi**

Pas përfundimit të funksionimit, parashikohet çmontimi i pajisjeve dhe rehabilitimi i terrenit, në mënyrë që zona të kthehet në një gjendje të përafërt me atë para realizimit të projektit.

### **Plani për menaxhimin e mjedisit**

Alternativa e zgjedhur mbështetet nga një plan i menaxhimit të mjedisit, i cili përcakton masat organizative dhe teknike për mbrojtjen e mjedisit gjatë gjithë ciklit jetësor të projektit.

### **Alternativa pa veprim**

Alternativa pa veprim nënkupton mos-realizimin e projektit, çka do të rezultonte në mungesë të kontributit në prodhimin e energjisë nga burime të ripërtëritshme dhe në humbjen e përfitimeve mjedisore dhe socio-ekonomike që sjell projekti i propozuar.

# **PËRSHKRIMI I NDIKIMIT TË PROJEKTIT NË MJEDIS**

## **Përshkrimi i përgjithshëm i ndikimeve të projektit në mjedis**

Ndikimet në mjedis shfaqen si rezultat i ndërhyrjes antropogjene gjatë fazave të ndërtimit dhe funksionimit të projektit. Vlerësimi i ndikimeve është realizuar duke u bazuar në projektin ideor të impiantit fotovoltai 1.5 MWp “Dallashaj”, si dhe në gjendjen ekzistuese të mjedisit në lokacionin e propozuar. Analiza synon të identifikojë ndikimet potenciale fiziko-kimike, biologjike-ekologjike dhe socio-ekonomike, në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjes së mjedisit.

## **Cilësia e ajrit**

Gjatë fazës së ndërtimit, ndikimet në cilësinë e ajrit lidhen kryesisht me emetimet nga makineritë ndërtimore dhe automjetet transportuese, të cilat përfaqësojnë burime lëvizëse të ndotjes së ajrit. Gjithashtu, aktivitetet si gërmimet, nivelimi i tokës, hapja e kanaleve dhe lëvizja e mjeteve të rënda mund të shkaktojnë ngritje të përkohshme të pluhurit.

## **Përqendrimi i substancave ndotëse në ajër dhe krahasimi me standardet**

Emetimet gjatë fazës së ndërtimit janë të kufizuara në kohë dhe intensitet dhe nuk pritet të tejkalojnë vlerat kufitare të përcaktuara me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e ajrit. Për shkak të natyrës së përkohshme të punimeve, këto emetime nuk pritet të kenë ndikim afatgjatë në cilësinë e ajrit.

## **Ndikimi në klimë dhe ndryshimet klimatike**

Projekti nuk përfshin procese djegieje gjatë fazës së operimit dhe, për rrjedhojë, nuk gjeneron emetime të gazeve serrë. Përkundrazi, prodhimi i energjisë nga burime të ripërtëritshme kontribuon pozitivisht në reduktimin e emetimeve të CO<sub>2</sub> në nivel lokal dhe kombëtar.

## **Ndikimi ndërkufitar në ajër**

Duke qenë se emetimet janë të lokalizuara dhe minimale, nuk parashikohet asnjë ndikim ndërkufitar në cilësinë e ajrit.

## **Cilësia e ujit**

Gjatë fazës së ndërtimit nuk parashikohen shkarkime të ujërave të ndotura industriale. Zona e projektit nuk ndodhet pranë trupave ujqorë sipërfaqësorë, çka redukton rrezikun e ndikimeve direkte në cilësinë e ujit.

### **Ndikimi në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore**

Niveli i ujërave nëntokësore ndodhet më thellë se niveli i gjërmimeve të planifikuara, prandaj nuk pritët ndotje e tyre gjatë ndërtimit. Rreziku potencial lidhet vetëm me ngjarje aksidentale, si derdhje e karburanteve ose vajrave nga mekanizmat ndërtimorë.

### **Ndikimi ndërkuftar në ujëra**

Për shkak të mungesës së shkarkimeve dhe distancës nga trupat ujqorë, nuk parashikohen ndikime ndërkuftare në ujëra.

### **Ndryshimet hidromorfologjike dhe ujërat e zeza**

Projekti nuk parashikon ndryshime në regjimin hidromorfologjik të zonës dhe nuk gjeneron ujëra të zeza industriale gjatë operimit.

### **Toka**

Ndikimet në tokë gjatë ndërtimit lidhen me gjërimet për kanalet kabllore, themelet dhe shtyllat mbajtëse. Këto ndërhyrje janë të kufizuara dhe të kthyeshme.

### **Ndikimi fizik, topografia dhe erozioni**

Ndryshimet në topografinë lokale janë minimale dhe përkohshme. Dheu i gjërmuar do të rimbushet dhe ngjeshet pas vendosjes së instalimeve, duke rikthyer sipërfaqet e prekura në gjendje të përafërt me atë fillestare.

### **Ndotja e tokës dhe krahasimi me standardet**

Nuk pritët ndotje e tokës që tejkalon normat ligjore. Rreziku potencial i ndotjes lidhet vetëm me derdhje aksidentale të substancave ndihmëse, të cilat janë të menaxhueshme.

### **Shfrytëzimi i tokës dhe burimeve natyrore**

Projekti shfrytëzon një sipërfaqe toke pa përdorime intensive urbane dhe nuk përfshin shfrytëzim të burimeve natyrore përveç rrezatimit diellor.

### **Humbja e tokës bujqësore**

Humbja e tokës bujqësore vlerësohet si e kufizuar dhe e kontrolluar, pasi toka nuk përdoret intensivisht për bujqësi të specializuar.

### **Ndikimi në karakteristikat gjeologjike dhe gjeomorfologjike**

Nuk parashikohen ndryshime të përhershme në strukturën gjeologjike apo gjeomorfologjike të zonës.

### **Popullsia lokale**

Projekti nuk kërkon zhvendosje të popullsisë dhe nuk prek drejtpërdrejt vendbanime ekzistuese.

### **Ndryshimet demografike**

Nuk priten ndryshime në strukturën demografike, migrim apo përqendrim i ri i popullsisë.

### **Ndikimet vizuale**

Ndikimi vizual vlerësohet si i moderuar, duke qenë se panelet fotovoltaike kanë lartësi të ulët dhe zona është kryesisht rurale.

### **Zhurma, vibrimet dhe shëndeti i njeriut**

Gjatë ndërtimit, nivelet e zhurmës mund të arrijnë 55–65 dB, por për shkak të distancës nga vendbanimet nuk pritet ndikim i ndjeshëm në shëndetin e njeriut.

### **Ndikimet socio-ekonomike**

Projekti pritet të ketë ndikime pozitive socio-ekonomike përmes krijimit të vendeve të përkohshme të punës gjatë ndërtimit.

### **Ndikimi në strukturën e ekonomisë lokale**

Projekti kontribuon në diversifikimin e aktiviteteve ekonomike dhe sektorit energjetik lokal.

## **Vendet e punës**

Gjatë ndërtimit do të krijohen vende të përkohshme pune, ndërsa gjatë operimit nevojitet staf minimal për mirëmbajtje.

## **Kontributi në ekonominë rajonale dhe kombëtare**

Prodhimi i energjisë nga burime të ripërtëritshme kontribuon në sigurinë energjetike dhe ekonominë kombëtare.

## **Ekosistemet dhe gjeologjia**

Projekti nuk prek ekosisteme të mbrojtura apo zona me ndjeshmëri të lartë ekologjike.

## **Humbja e biodiversitetit**

Ndikimet në florë dhe faunë janë të kufizuara dhe të përkohshme, pa dëmtim të specieve të mbrojtura.

## **Speciet e rralla dhe habitatet**

Nuk janë identifikuar specie të rralla ose të rrezikuara në zonën e projektit.

## **Qëllimi dhe shfrytëzimi i sipërfaqeve**

Sipërfaqja përdoret ekskluzivisht për prodhim energjie nga burime të ripërtëritshme.

## **Sipërfaqet e ndërtuara dhe të pandërtuara**

Projekti ruan një balancë midis sipërfaqeve të ndërtuara dhe atyre të gjelbra.

## **Shfrytëzimi i tokës**

Shfrytëzimi i tokës është i kontrolluar dhe i kthyeshëm pas përfundimit të funksionimit.

## **Infrastruktura komunale**

Projekti nuk ngarkon infrastrukturën komunale ekzistuese.

## **Trafiku**

Rritje e përkohshme e trafikut pritet vetëm gjatë fazës së ndërtimit.

## **Furnizimi me ujë**

Kërkesat për ujë janë minimale dhe nuk ndikojnë në furnizimin lokal.

## **Energjia**

Projekti përfaqëson burim të qëndrueshëm të energjisë elektrike nga burime të ripërtëritshme.

## **Ujërat e zeza**

Gjatë fazës së ndërtimit, ujërat e zeza gjenerohen vetëm nga nevojat sanitare të personelit të angazhuar në punishten e ndërtimit. Këto ujëra do të menaxhohen përmes rezervuarëve septikë të mbyllur ose sistemeve të përkohshme sanitare, pa shkarkime direkte në tokë ose në trupa ujqorë. Gjatë fazës së operimit, impianti fotovoltaiik nuk gjeneron ujëra të zeza industriale, pasi funksionimi është i automatizuar dhe kërkon ndërhyrje minimale njerëzore.

## **Gjenerimi i mbeturinave**

Gjatë fazës së ndërtimit pritët gjenerim i mbeturinave jo të rrezikshme, kryesisht nga materialet ndërtimore, ambalazhet e pajisjeve dhe mbeturinat komunale të stafit. Mbeturina të rrezikshme mund të krijohen vetëm në rast të derdhjeve aksidentale të vajrave ose karburanteve nga mekanizmat ndërtimorë. Gjatë fazës së operimit, mbeturinat janë minimale dhe lidhen kryesisht me mirëmbajtjen periodike të pajisjeve.

## **Pasuritë e mbrojtura natyrore, kulturore dhe veçoritë e peizazhit**

Zona e projektit nuk përfshin pasuri të mbrojtura natyrore apo kulturore dhe nuk ndodhet brenda kufijve të zonave të mbrojtura. Ndikimi në peizazh vlerësohet si i moderuar dhe i integrueshëm në karakterin rural të zonës.

## **Informacione shtesë mbi ndikimet**

Përshkrimi i ndikimeve merr parasysh edhe ndikimet që mund të rezultojnë nga zbatimi i projektit në tërësi, duke përfshirë fazat e ndërtimit, operimit dhe, sipas rastit, largimit të instalimeve pas përfundimit të funksionimit.

## **Zbatimi i projektit dhe punimet e largimit**

Pas përfundimit të ciklit jetësor të projektit, parashihet çmontimi i instalimeve dhe rehabilitimi i sipërfaqes, me qëllim rikthimin e terrenit në një gjendje sa më të afërt me atë fillestare.

### **Ndikimet kumulative**

Ndikimet kumulative vlerësohen si të ulëta, pasi zona nuk karakterizohet nga përqendrim i projekteve të mëdha industriale. Projekti nuk pritet të krijojë presion shtesë të ndjeshëm mbi komponentët mjedisorë ekzistues.

### **Shtrirja hapësinore e ndikimeve negative**

Ndikimet negative janë të kufizuara kryesisht brenda kufijve të parcelës së projektit dhe janë të përkohshme gjatë fazës së ndërtimit.

### **Shkarkimi i ujërave të ndotura gjatë ndërtimit**

Nuk parashikohen shkarkime të ujërave të ndotura industriale gjatë ndërtimit. Menaxhimi i ujërave sanitare do të realizohet në përputhje me kërkesat ligjore.

### **Rrezatimi elektromagnetik gjatë ndërtimit**

Gjatë fazës së ndërtimit nuk gjenerohen nivele të rrezatimit elektromagnetik që tejkalojnë kufijtë e lejuar. Pajisjet elektrike instalohen sipas standardeve teknike dhe rregulloreve në fuqi.

### **Emetimet e gazeve serrë gjatë operimit**

Gjatë fazës së operimit nuk ka emetime direkte të gazeve serrë, pasi prodhimi i energjisë realizohet përmes burimit diellor. Projekti kontribuon në uljen e emetimeve të CO<sub>2</sub> në sistemin energjetik.

### **Ndikimet në ndryshimet klimatike**

Projekti ka ndikim pozitiv në kontekstin e ndryshimeve klimatike, duke kontribuar në tranzicionin drejt burimeve të pastra të energjisë dhe reduktimin e varësisë nga karburantet fosile.

# **PËRSHKRIMI I MASAVE PËR TË PARANDALUAR, REDUKTUAR OSE ELIMINUAR NDIKIMIN NË MJEDIS**

Masat mbrojtëse duhet të mirren për arsye të parandalimit dhe zvogëlimit të ndikimeve në mjedis gjatë fazës së ndërtimit dhe operimit. Masat për zvogëlimin e ndikimeve të mundshme negative në mjedis janë paraqitur në vijim. Masat e paraqitura duhet të implementohen plotësisht. Për implementimin e tyre përgjegjës është investitori.

Ndikimet mjedisore dhe sociale janë të ndërlidhura me aktivitete të përgjithshme të zhvillimit për projektin Fotovoltaik të cilat mund të kategorizohen si më poshtë :

- Faza para ndërtimit: e cila përfshinë përgatitjen e vendit, sigurimi i paisjeve dhe materialeve në zonën e projektit.
- Faza e ndërtimit dhe instalimeve: punët konstruktive, punimet elektrike dhe instalimi i pajisjeve.
- Operimi: funksionimi i impiantit dhe mirëmbajtja e rregullat e tijë.
- Demontimi/ mbyllja: çmontimi i pajisjeve dhe rehabilitimi i zonës.

## **Masat e parashikuara me legjislacion**

Zbatimi i projektit do të realizohet në përputhje të plotë me legjislacionin mjedisor në fuqi, kushtet e pëlqimit mjedisor dhe standardet teknike për ndërtim dhe operim të impianteve energjetike.

## **Masat në rast aksidentesh dhe fatkeqësish**

Parashikohen masa për reagim në rast të derdhjeve aksidentale, zjarreve, defekteve teknike ose ngjarjeve të tjera të paparashikuara, duke përfshirë procedurat e emergjencës dhe njoftimin e autoriteteve kompetente.

## **Zgjidhjet teknike për mbrojtjen e mjedisit**

Zgjidhjet teknike përfshijnë përdorimin e pajisjeve moderne, sistemeve të tokëzimit, mbrojtjes nga mbitensionet dhe menaxhimin e kontrolluar të mbeturinave dhe materialeve ndihmëse.

## **Masa shtesë për reduktimin e ndikimeve**

Masat shtesë përfshijnë organizimin e punimeve në orare të përshtatshme, kufizimin e ndërhyrjeve në terren dhe rehabilitimin e sipërfaqeve të prekura.

# **PROGRAMI I MONITORIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS**

## **Programi i monitorimit**

Do të zbatohet një program monitorimi për të vlerësuar ndikimet mjedisore gjatë fazave të ndërtimit dhe operimit.

## **Gjendja mjedisore fillestare**

Gjendja mjedisore para fillimit të punimeve shërben si bazë krahasimi për vlerësimin e ndryshimeve të mundshme gjatë realizimit të projektit.

## **Parametrat e monitorimit**

Monitorimi përfshin parametra të tillë si cilësia e ajrit, zhurma, menaxhimi i mbeturinave dhe respektimi i kushteve mjedisore.

## **Vendndodhja dhe shpeshësia e matjeve**

Matjet realizohen në zonën e projektit dhe, sipas nevojës, në rrethinën e saj, me frekuencë të përshtatur sipas fazës së projektit.

## **Raportimi i rezultateve**

Rezultatet e monitorimit dokumentohen dhe raportohen sipas kërkesave ligjore.

## **Informimi i publikut**

Publiku informohet për rezultatet e monitorimit në përputhje me procedurat ligjore për transparencë.

## **Monitorimi ndërkufitar**

Për shkak të natyrës së projektit, nuk parashikohet nevojë për monitorim ndërkufitar.

# **PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR**

## **Mbrojtja mjedisore gjatë gjithë fazave të projektit**

Plani i menaxhimit mjedisor siguron zbatimin e masave mbrojtëse gjatë ndërtimit, operimit dhe çmontimit të projektit.

## **Pajtueshmëria me pëlqimin mjedisor**

Të gjitha aktivitetet do të zhvillohen në përputhje me kushtet e përcaktuara në pëlqimin mjedisor.

## **Sistemi i menaxhimit mjedisor**

Investitori inkurajon zhvillimin dhe zbatimin e një sistemi të menaxhimit mjedisor në përputhje me standardin ISO 14000.

# **INFORMACIONE SHITESË DHE KARAKTERISTIKAT E PROJEKTIT**

## **Informacionet dhe karakteristikat shitesë të projektit**

Ky kapitull përfshin informacionet shitesë dhe karakteristikat specifike të projektit të Parkut Fotovoltaik “Dallashaj”, të cilat janë të nevojshme për përcaktimin e plotë të qëllimit, përmbajtjes dhe vlerësimit të ndikimeve mjedisore në kuadër të këtij raporti të VNM-së. Informacionet shitesë lidhen kryesisht me natyrën e teknologjisë së përdorur, mënyrën e funksionimit të impiantit, si dhe përputhshmërinë e projektit me politikat kombëtare dhe strategjitë për zhvillimin e energjisë nga burime të ripërtëritshme.

Projekti është konceptuar si një impiant modern për prodhimin e energjisë elektrike nga energjia diellore, me funksionim të automatizuar dhe kërkesa minimale për ndërhyrje njerëzore gjatë fazës së operimit. Karakteristikat teknike të projektit janë përshtatur për kushtet klimatike dhe gjeografike të zonës, duke siguruar efikasitet të lartë dhe ndikime të ulëta mjedisore. Gjithashtu, projekti është planifikuar në përputhje me dokumentet planifikuese hapësinore dhe me legjislacionin në fuqi, duke kontribuar në rritjen e kapaciteteve prodhuese të energjisë së pastër dhe në përmbushjen e objektivave për reduktimin e emetimeve të gazeve serrë.

## **BURIMET E TË DHËNAVE**

### **Lista e referimit të burimeve dhe të dhënave të përdorura**

- Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM), Ligji Nr. 08/L-181, Republika e Kosovës.
- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligji Nr. 03/L-025, Republika e Kosovës.
- Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, Ligji Nr. 03/L-160, Republika e Kosovës.
- Ligji për Ujërat, Ligji Nr. 04/L-147, Republika e Kosovës.
- Ligji për Mbeturinat, Ligji Nr. 04/L-060, Republika e Kosovës.
- Udhëzimi Administrativ për Procedurat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI).
- Plani Zhvillimor Komunal i Gjakovës 2022–2030, Komuna e Gjakovës.
- Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2019–2023, Komuna e Gjakovës.
- Dokumentacioni teknik i projektit të Parkut Fotovoltaik 1.5 MWp “Dallashaj”, projekt ideor dhe specifikime teknike, investitori.
- Geoportal, Google Earth, imazhe satelitore për verifikimin e përdorimit të tokës dhe karakteristikave të terrenit në zonën e projektit.

## **SHTOJCAT**

- a) Dëshmi e pagesës për aplikim për pëlqim mjedisor
- b) Dëshmi për vlerën financiare investuese të projektit
- c) Certifikata e biznesit
- d) Certifikata e tokës – 00663-0
- e) Kopja e Planit – 00663-0
- f) Plani i situacionit dhe licenca e gjeodetit
- g) Kontratë e noterizuar për blerjen e tokës
- h) Ekstrakt - Informatë nga Harta Zonale Komunale 2024-2032, Komuna Gjakovë
- i) Përmbledhje joteknike e Raportit të VNM-së
- j) Licenca – Hana Zeka

## PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE E PROJEKTIT

Kjo Përmbledhje Jo-Teknike paraqet në mënyrë të thjeshtuar përmbajtjen kryesore të Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM), i cili është përgatitur me kërkesë të investitorit për marrjen e Pëlqimit Mjedisor për realizimin e projektit të propozuar. Investitori i projektit është kompania “ohm” SH.P.K. Projekti ka të bëjë me ndërtimin dhe operimin e një parku fotovoltaik tokësor me kapacitet të instaluar 1.5 MWp, me titull të plotë “Park Fotovoltaik 1.5 MWp ‘DALLASHAJ’”, i planifikuar të zhvillohet në parcelën kadastrale P-70705066-00663-0 në zonën kadastrale Rracaj, Komuna Gjakovë, me sipërfaqe totale rreth 3.5 ha. Raporti i VNM-së është hartuar nga Hana Zeka, eksperte e licencuar nga MMPHI për hartimin e raporteve të VNM-së.

Projekti synon shfrytëzimin e energjisë së ripërtëritshme diellore për prodhim të energjisë elektrike dhe lidhjen në rrjetin distributiv sipas kushteve teknike të operatorit përkatës. Funksionimi i impiantit bazohet në shndërrimin e rrezatimit diellor në energji elektrike përmes paneleve fotovoltaike, të cilat gjenerojnë rrymë të drejtë (DC) dhe më pas kjo energji konvertohet në rrymë alternative (AC) përmes invertorëve, për t’u injektuar në rrjet përmes infrastrukturës elektrike dhe nënstacionit ngritës. Në fazën e ndërtimit parashihi punë përgatitore dhe instalime, duke përfshirë sistemimin e terrenit, krijimin e rrugëve të brendshme të qasjes, shtrirjen e kablllove, vendosjen e strukturave mbështetëse dhe montimin e paneleve, instalimin e pajisjeve elektrike, tokëzimin, si dhe testimin dhe komisionimin e sistemit. Në fund të jetës së projektit parashikohet çmontimi i pajisjeve dhe rehabilitimi i sipërfaqes për ta kthyer terrenin në gjendje sa më të përafërt me atë paraprake.

Gjendja ekzistuese e lokacionit karakterizohet nga një zonë kryesisht rurale, jashtë qendrave të dendura të banuara. Brenda parcelës së projektit nuk ka objekte të banimit dhe nuk parashikohet zhvendosje e popullsisë. Zona përreth përmban sipërfaqe të paurbanizuara dhe përdorime kryesisht bujqësore, ndërsa në vetë zonën janë evidentuar pyje të degraduara/ të prera dikur, me rikuperim natyror të vegjetacionit, ku gjatë verifikimit në terren është konstatuar prania e një pylli të ri të përzier me dominim të dushkut (*Quercus spp.*) dhe lloje të tjera shoqëruese. Fauna përfaqësohet kryesisht nga specie të zakonshme, sidomos shpezë tipike për zonat rurale, pa evidencë të drejtpërdrejtë të specieve të rralla ose të rrezikuara në parcelë. Lokacioni i projektit nuk ndodhet brenda zonave të mbrojtura natyrore dhe nuk janë identifikuar objekte të mbrojtura të trashëgimisë kulturore apo historike në zonën e projektit ose në afërsi të saj.

Ndikimet kryesore mjedisore pritet të shfaqen kryesisht gjatë fazës së ndërtimit dhe të jenë të përkohshme e të kufizuara brenda kufijve të parcelës. Në aspektin e cilësisë së ajrit, ndikimi lidhet me pluhurin nga gërmimet, nivelimi dhe lëvizja e automjeteve, si dhe me emetimet nga makineritë ndërtimore. Këto ndikime pritet të jenë të kufizuara në kohë dhe të menaxhueshme me masa standarde. Në aspektin e ujërave, duke qenë se në parcelë nuk ka trupa ujore sipërfaqësore dhe ujërat nëntokësore konsiderohen më të thella se niveli i gërmimeve, nuk parashikohen ndikime të drejtpërdrejta; rreziku kryesor potencial lidhet me derdhje aksidentale të karburanteve/vajrave nga pajisjet, që do të trajtohet me masa parandaluese dhe emergjente. Ndikimet në tokë lidhen me gërmimet për kanale kablllore dhe themele, të cilat janë të kufizuara dhe të kthyeshme, me rikthim të dheut të gërmuar dhe rehabilitim pas punimeve. Gjenerimi i mbeturinave gjatë ndërtimit përfshin kryesisht mbetje inerte, ambalazhe dhe mbeturina komunale, ndërsa mbetje të rrezikshme mund të shfaqen vetëm në raste të izoluara (p.sh. vajra të përdorura ose derdhje). Zhurma gjatë punimeve mund të rritet përkohësisht nga funksionimi i makinerive dhe trafiku i mjeteve, por për shkak të distancës nga vendbanimet nuk pritet ndikim i ndjeshëm në shëndetin e njeriut. Në biodiversitet, ndikimet pritet të jenë të kufizuara dhe të përkohshme, kryesisht nga pastrimi i sipërfaqeve dhe prania e punimeve, ndërsa në peizazh ndikimi vlerësohet i moderuar, pasi panelet kanë lartësi të ulët dhe zona është kryesisht rurale. Në aspektin socio-ekonomik priten ndikime pozitive nga angazhimi i fuqisë punëtore gjatë ndërtimit, ndërsa gjatë operimit kërkohet staf minimal për mirëmbajtje.

Masat kryesore për parandalimin dhe zbutjen e ndikimeve përfshijnë: kontrollin e pluhurit me ujtitje të sipërfaqeve dhe kufizim të shpejtësisë së automjeteve; mirëmbajtje teknike të makinerive për reduktim të emetimeve; organizim të punimeve dhe respektim të orareve për minimizim të zhurmës; menaxhim të mbeturinave përmes ndarjes, ruajtjes së sigurt dhe dorëzimit tek operatorë të autorizuar; parandalim të ndotjes së tokës/ujërave me rregulla për ruajtjen e karburanteve dhe pajisje me materiale absorbente për derdhje aksidentale; si dhe rehabilitim të sipërfaqeve të prekura pas përfundimit të punimeve. Programi i monitorimit parashikon inspektime dhe kontroll të zbatimit të masave gjatë ndërtimit dhe operimit, dokumentim të rezultateve dhe ruajtje të evidencave për pajtueshmëri me kushtet e Pëlqimit Mjedisor.

Në përfundim, projekti “Park Fotovoltaik 1.5 MWp ‘DALLASHAJ’” vlerësohet i realizueshëm nga aspekti mjedisor, me ndikime kryesisht të përkohshme gjatë ndërtimit dhe me ndikime shumë të ulëta

gjatë operimit. Projekti kontribuon pozitivisht në prodhimin e energjisë së pastër dhe në reduktimin e emetimeve të gazeve serrë, me kusht që masat mbrojtëse dhe monitorimi të zbatohen në mënyrë të plotë gjatë gjithë ciklit jetësor të projektit.